


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE E
UJËSJELLËS POLIÇAN SH.A.

V E N D I M

Nr. 13 date 07.12.2016

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a., mbështetur në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

V E N D O S I:

1. Të caktojë si eksperte kontabël audituesit ligjor Z.Dhimo Dundo dhe Z.Afrim Suli për:
 - a) Zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a nepermjet transferimit të aktiveve materiale të ish Komunës Vërtoq, që aktualisht janë në aktivet materiale të shoqërisë "Ujësullës Berat-Kuçovë" sh.a, pasi ish Komuna Vërtoq ka kaluar në juridiksionin teritorial të Bashkisë Poliçan;
 - b) Zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a nëpërmjet aktiveve të ish Komunave Tërpan e Vërtoq që kanë kaluar në juridiksionin teritorial të Bashkisë Poliçan.
 - c) Zvogëlimin e Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a me aktivet materiale të ish Komunës Bogovë që kanë kaluar në juridiksionin teritorial të Bashkisë Skrapar.
2. Ngarkohet drejtori i shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të zbatohet brenda dates 31.12.2016.

AKSIONARI I UJËSJELLËS POLIÇAN SH.A.

KRYETARI BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UJËSJELLËS POLIÇAN

Nr. 93 Prot.

Poliçan, më: 21 .02.2017

V E N D I M

Nr. 26 Date 21.02.2017

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a. bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

V E N D O S I

1. Miratimin e raportit të ekspertëve kontabël për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a, të caktuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme të aksionarëve, nr.13, datë 07.12.2016.
2. Të zmadhojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a, për 66,603 aksione të reja, me vlerë nominale 1.000 lekë për aksion dhe vlerë të përgjithëshme 66,603,000 lekë. Aksionet e reja të emetuara përfitohe nga Aksionari-Bashkia Poliçan.
3. Të zvogelojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me 9,932 aksione, me vlerë të përgjithëshme 9,931,612 lekë. Largohet si aksionar i shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a, Aksionari Bashkia Çorovodë, kundrejt likuidimit të aksioneve që zotëron për vlerën 9,781,139 lekë.
4. Pas operacioneve të mësipërme kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësullës Poliçan" sh.a do të jetë 102,545,000 lekë i ndarë në 102,545 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhe zotërohet 100% nga aksionari i vetëm Bashkia Poliçan.
5. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).

KRYETARI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
ADRIATIK ZOTKAJ

